

# KONTRATA TË LIDHURA JASHTË QENDRAVE TË TREGTIMIT



Организација на потрошувачите  
на Македонија



Министерство за Економија



**K**ur do dëgjojmë për kontrata të nënshkruara jashtë hapësirave afariste zakonisht na kujtohen kontratat e lidhura në largësi. Me shitjen nga larg nënkuptohet ofrim i mallrave ose shërbimeve me ndihmën e mjeteve të ndryshme të komunikimit me konsumatorin i cili nuk është prezent por me anë të telefonit ose me pagesë ta realizoj blerjen. Këtu bëjnë pjesë shitjet nga katalog, fletë-njoftime të shtypura, materiale reklamuese dhe porosi, telefona, automate e të ngjashëm.

Shitja jashtë hapësirave afariste në fakt paraqet shitje në lëvizje, shitje nga derë në derë, shitja në hotel, shitja në restorant, etj. Këto janë raste në të cilat shitja nuk realizohet në hapësirat afariste të afaristit por ai dhe blerësi janë fizikisht të pranishëm në vendin ku realizohet shitja. Me rëndësi është se edhe për shitjen nga larg edhe për shitjen jashtë hapësirave afariste vlejnë rregulla të ngjashme.

Megjithatë ekziston një dallim i caktuar. Tek kontratat nga larg afaristi dhe konsumatori gjinden në largësi, gjegjësisht nuk janë fizikisht të pranishëm në hapësirë të njëjtë. Tek kontratat jashtë hapësirave afariste, afaristi, udhëtuesi afarist dhe konsumatori, siç kemi thënë më, janë fizikisht të pranishëm në një hapësirë të njëjtë, kur shpaloset oferta ose kur lidhet kontrata, por kjo hapësirë nuk është hapësira afariste e afaristit, por hapësirë krejtësisht tjetër.

Kontrata të lidhura jashtë hapësirave afariste janë kontratat për të cilat: afaristi bën prezantim në shtëpinë tuaj, në vendin tuaj të punës, bën prezantim për të cilën jeni të ftuar në hotel, tek miq tuaj, anëtarë të familjes ose në ndonjë vend tjetër, i cila nuk përputhet me adresën e hapësirë së tij afariste. Gjithsesi te zgat verore, te zgat kur ka festa dhe panaire ku shpaloset firma e afariste llogariten si hapësirë e tij afariste.

Lidhja e kontratave jashtë hapësirave afariste kufizohet me praktikën agresive tregtare dhe kontratat e tilla ndonjë herë përmbajnë edhe dispozita të padrejta pasi që në fakte shfrytëzohet gjendja e relaksuar e konsumatorit, siç është pushimi vjetor, fundjava, darkë romantike ose presioni psikologjik vetëm sot, vetëm në këtë orë me qëllim që të bindet konsumatori ti dorëzohet marketingut mirë të menduar dhe me vite të tëra i studiuar.

Kujdes! Çdo herë mendoni mirë para se të lidhni kontratë. Jetojmë në një epokë të shoqërisë konsumatorë me marketing shumë agresiv. Kontratat e lidhura jashtë hapësirave afariste paraqesin kontrata të cilat lidhen në situatë kur konsumatori është i "bombarduar" nga tregtari me metoda profesionale dhe të sofistikuara dhe me bindje (të cilat sot përsosen në mënyrë shkencore në fakultete) dhe konsumatori është i detyruar që ta lidh kontratën, pasi që në atë moment ai fiton përshtypje se lidhja e kontratës paraqet interes më të lartë për atë. Por kur konsumatori do të largohet nga vendi i ngjarjes, nga prezantimi, kur nuk do të jetë nën ndikimin e tregtarit, atëherë ati i bëhet e qartë se ai nuk ka nevojë për atë produkt ose shërbim dhe thjeshtë dëshiron të lirohet nga obligimi i kontratës.

E drejta për edukim dhe informim të konsumatorëve na nxiti që t'ju informojmë edhe në këtë mënyrë për të drejtat e juaja, sidomos çdo herë kur ju ofrohet ndonjë ofertë ose lidhni kontratë jashtë hapësirave afariste të

afaristit duhet të jeni të informuar për të drejtën tuaj e cila ju mundëson që pa as një shpjegim ose arsye ta shkëputni kontratën në afat prej 14 ditë. Kjo periudhë njihet si periudhë për ftohje ose me kokë të freskët, pa presione të mund të mendoni a është opsioni më i mirë për ju lidhja e kontratës.

Mos lejoni që të atmosfera në ndonjë ekskursion ose udhëtim të ju bëjë që pa menduar të blini ndonjë produkt për të cilin nuk keni nevojë. Nëse jeni mysafir në ndonjë shtëpi ku organizohet ndonjë prezantim, mos blini vetëm që ta kënaqni nikoqiren, mendoni mirë a keni nevojë në atë moment për ato prodhime.

Ka shumë tregtarë të cilët prodhimet e tyre i ofrojnë në hapësira të cilat janë jashtë hapësirave të tyre afariste. Këtu nuk bëjnë pjesë tezgat e tregtarëve në shitje të organizuara gjatë festave, ditë të dedikuara ndonjë rasti, por këto tezgat të përkohshme llogariten si hapësira afariste të tregtarëve. Kontrata të lidhura jashtë hapësirave afariste të tregtarit janë kontratat të cilat lidhen me prezencë fizike të konsumatorit dhe tregtarit në hapësirë e cila është jashtë hapësirës afariste e tregtarit, ose kur për këto kontrata është negociuar, ose është dhënë ofertë, kur fizikisht kanë qenë prezentë edhe tregtarin edhe konsumatori në hapësirë e cila është jashtë hapësirave afariste të tregtarit, ndërsa më pas kontrata mund të lidhet me ndonjë mjetë për lidhjen e kontratave nga larg.

Duhet që të njoftohemi me disa terme themelore për kontratat e lidhura jashtë hapësirave afariste. Sigurisht që disa gjëra siç është prona e patundshme mund ti shohim dhe për ata të lidhet kontratë jashtë hapësirave afariste, p.sh. tokë, tokë për ndërtim, banesë ose apartament.

### **Çka janë hapësirat afariste të tregtarit? Legjislacioni jon hapësirat afariste të tregtarit i ka definuar si:**

- a) Hapësira të patundshme të cilat shfrytëzohen për shitje me pakicë, ku tregtari kryen veprimtarinë e tij në mënyrë të vazhdueshme;
- a) hapësira të patundshme të cilat shfrytëzohen për shitje me pakicë, ku tregtari kryen veprimtarinë e tij në baza të zakonshme.

### **Çka është veçantë për kontratat e lidhura jashtë hapësirave afariste të tregtarit?**

Fillimisht është se tregtari duhet të japë më shumë informata të patjetërsuara konsumatorit, edhe ajo se tregtari duhet të lajmërojë konsumatorin se mundet të tërheq kontrata në afat prej 14 ditësh.

### **Cilat janë kontratat më të zakonshme që i lidhen jashtë hapësirës afariste të tregtarit?**

Për shembull, shitja e pajisjeve për pastrim (me vakum) përmes prezantimeve të ndryshme në shtëpitë e juaja. Ata tregojnë se sa të përljer janë qilimat, pllakat, krevatet në të cilët flini nëse pastrimi bëhet vetëm në një pjesë të tyre. Ju të brengosur për higjienën fitoni dhe mundësi për pagesë me këste nëpërmjet kartelës dhe vendosni për të blerë prodhimin e shtrenjtë. Cilat janë të drejtat e juaja? Si mundë ti realizoni ato?

Duke ofruar shërbim për pastrim të hapësirave, pllakave, qilimave me mjete të shëndetshme për ju dhe për rrethin tuaj. Prezantim në shtëpinë tuaj ose tek fqinjët dhe ofertë për të lidhur marrëveshje me çmim të caktuar për metër katrorë hapësirë për pastrim. Ju konvenon dhe ende po mendoheni? Pagesa është bërë? Çfarë mundë të bëni?

Në shtëpinë tuaj ju vjen një prezantues që do të ju tregojë vaskën për pedikir ose vaskën e cila përmes këmbëve kryhen detoksifikimin. Do të bindeni se në mënyrë magjike do të liroheni nga toksinat përmes dhjetë tretmanëve dhe atë përmes tabletave për shtypje, diabet, dhimbje të lukthit. I vendoni këmbët dhe vaska bëhet me ngjyrë e errët. Prezantuesi shpjegon se pas 10 tretmanëve ngjyra do të jetë më e hapur. E blini edhe pse është mjaft i shtrenjtë. Dhe provoni nëse uji do të bëhet me ngjyrë pa i venduar këmbët. Ajo bëhet me ngjyrë. Këtu kemi një marrëveshje të arritur jashtë hapësirave afariste dhe praktikë të padrejtë të biznesit. Cilat janë të drejtat tuaja? Si mund ti realizoni ata?

Në udhëtime turistike shesin bizhuteri me magnet të cilat ndihmojnë për shëndetin. Atmosfera relaksuese ju shty të shpenzoni më shumë para nga ajo që keni planifikuar. Ju japin mundësi të paguani me këste pas ardhjes në shtëpi. Cilat janë të drejtat tuaja, nëse ndryshoni mendjen? Si mundë ti realizoni ato?

Në darkë në një restorant të mirë, organizuar nga prezantuesi i cili ju ofron fundjavë për dy persona jashtë vendit për një shumë caktuar parash që mundë ta realizoni kur të doni ju, por duhet të paguani tani, që të fitoni çmim më të volitshëm. Cilat janë të drejtat e juaja nëse mendoni se keni harxhuar më shumë para dhe se pushimi për dy persona nuk ju nevojitet. Si mundë ti realizoni ato?

Ja cilat informacione tregtari është i obliguar t'ju tregon kur lidhni kontrata jashtë hapësirave afariste para se, ju si konsumatorë të lidhni kontratë. Këto të dhëna tregtari është i obliguar t'ju japë edhe atëherë kur ju jepet ofertë për lidhje të kontratës jashtë hapësirave afariste.

### **Informatat duhen të jenë të qarta dhe të kuptueshme:**

a) karakteristika kryesore të mallrave ose shërbimeve, deri në masën e duhur të transportimit të mallrave ose shërbimeve;

b) identiteti i tregtarit, ashtu siç është emri tregtarë i tij;

c) selia e tregtarit dhe numrin e telefonit, faks dhe adresën elektronike, që të ndihmojë konsumatorin më shpejtë ta kontaktojë tregtarin dhe në mënyrë më efektive të komunikojë me të edhe nëse është aplikueshme, selia dhe identiteti i tregtarit në emrin e kujt e kryen veprimtarinë e tij;

d) në qoftë se është ndryshe nga selia, selia gjeografike e tregtarit, ku konsumatori mundë të dërgojë ankesa eventuale dhe në qoftë se është e aplikueshme, tregtari në emrin e kujt e kryen veprimtarinë e tij;

e) çmimi i përgjithshëm i mallrave dhe shërbimeve, duke përfshirë dhe tatimin, ose në qoftë se natyra e mallrave dhe shërbimeve është e pamundur që paraprakisht të llogariten çmimet, metoda e llogaritjes së çmimit dhe në qoftë se ndryshohet, të gjitha harxhimet shtesë për transport, shpërndarje ose harxhimet postare dhe çdo shpenzim tjetër ose dhe kur këto shpenzime nuk mundë të llogariten paraprakisht, nga fakti se këto shpenzime shtesë mundë të paguhen.

Në rast se një kontratë e përhershme ose një kontratë që përmban abonim, atëherë çmimi i përgjithshëm duhet të përfshijë shpenzimet e përgjithshme për periudhën e pagesës. Kur këto kontrata paguhen me formë fiskale, çmimi i përgjithshëm që është i barabartë, gjithashtu, me kosto totale mujore. Në qoftë se çmimet totale nuk mundë paraprakisht të llogariten ose të arsyetohen, duhet të sigurohet mënyrë për llogaritje të çmimit.

f) shpenzimet për shfrytëzim të mjeteve të komunikacionit, lidhur me lidhjen e kontratës, kur shpenzimi i tillë llogaritet mbi bazë të ndryshme nga norma bazë;

g) mënyra e pagesës, shpërndarja dhe realizimi, data kur tregtari merr përsipër ti porosis mallrat ose të sigurojë kushte në qoftë se është e aplikueshme, procedurën të cilën tregtari e aplikon për ti zgjidhur ankesat;

h) në rast kur ekziston e drejta për tërheqje, kushtet, afatet dhe procedurat për të realizuar atë të drejtë janë në pajtueshmëri me formularin e tërheqjes;

i) në qoftë se është e aplikueshme informacioni se konsumatori duhet të mbajë koston e kthimit të mallrave në rast të tërheqjes së kontratave në distancë shërbimet sipas natyrës së tyre nuk mund të kthehen nëpërmjet postes;

j) informacionet se shpenzimet e arsyeshme që janë bërë në lidhje me tërheqjen, do të shprehë tregtari;

k) nëse nuk është paraparë e drejta për tërheqje, informacioni se tregtari nuk do të ketë përfitim nga e drejta e tërheqjes edhe nëse është e aplikueshme, rrethanat ku tregtari humb të drejtën e tërheqjes;

l) se ka garanci ligjore për konformitet të mallrave;

m) në qoftë se është e aplikueshme, ekzistimi dhe kushtet për ndihmë tregtarë të konsumatorit, shërbimeve tregtare dhe garanci tregtare dhe

n) ekzistenca e kodeve relative të sjelljes.

Në lidhje me kontratat e lidhura jashtë hapësirave afariste, tregtari i siguron konsumatorit të gjitha informacionet e nevojshme të kërkuara me ligj, dhe në qoftë se shpenzuesi dakordohet, me një bartës tjetër të qëndrueshëm. Këto informacione duhen të jenë të lexueshme dhe të prezantuara me fjalë të thjeshta dhe të kuptueshme.

Tregtari, sipas ligjit, i siguron konsumatorit kopje të kontratës së nënshkruar ose vërtetim për kontratën, ose në qoftë se tregtari dakordohet, në një tjetër mbajtës duke e përfshirë, derisa është e aplikueshme, vërtetimi lidhur me dhënien e pëlqimit më parë dhe pranimi i shpenzuesit për partner.

Në qoftë se konsumatori dëshiron ofrimin e shërbimit ose furnizim me ujë, gaz apo energjisë elektrike, të cilat nuk bëjnë pjesë në shitje në shtrirje të kufizuar ose në masë të caktuar, ose ngrohja qendrore të filloj së punuari në prag të afatit të tërheqjes (14 ditë), tregtari kërkon konsumatorit ta paraqesë një kërkesë të qartë për një mbajtës të përhershëm.

Nuk do të zbatohen dispozitat ligjore mbi kontratat e negociuara larg ambientit të biznesit, ku konsumatori qartë i ka kërkuar kushtet nga tregtari me qëllim të kryerjes së punëve për riparim ose mirëmbajtje dhe në bazë të së cilës tregtari dhe konsumatori obligimet i kryejnë menjëherë, ndërsa sasia e mallrave të konsumimit nuk i kalon 200 euro në vlerë denarësh sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Maqedonisë, përcaktuar në ditën e pagesës.

### **Cilat të drejta si konsumatorë keni sipas ligjit për veç këto informacione dhe të dhëna të cilat detyrimisht duhet të ju prezantohen?**

Çdo konsumatorë ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata e lidhur jashtë hapësirave afariste në afat prej 14 ditësh. Për këtë të drejtë dhe për mënyrën e tërheqjes duhet të informohet tregtari. Tregtari duhet ti dërgoj formular për tërheqje. Nëse kjo nuk ndodhë dhe tregtari nuk e informon konsumatorin, afati për tërheqje, sipas ligjit vazhdohet në 12 muaj.

### **Kur fillon të skadojë afati prej 14 ditësh kur ekziston e drejta për tërheqjen e kontratës?**

Afati fillon të skadojë varësisht a bëhet fjalë për shitje të mallrave ose shërbimeve. Afati prej 14 ditë skadon: për kontrata për shërbime, nga dita e lidhjes së kontratës; për kontratat për shitje, nga dita kur konsumatori ose person i tretë, përveç transportuesit, ndërsa deklaruar nga konsumatori, fizikisht e pranon mallin ose; në rast kur më shumë mallra janë të porositura nga konsumatori me anë të një porosie, kërkuar nga konsumatori, fizikisht e pranon mallin e fundit; në rast të dërgimit të mallit i përbërë nga më shumë dërgesa ose pjesë, nga dita kur konsumatori ose person i tretë, përveç transportuesit, ndërsa përcaktuar nga konsumatori, fizikisht e pranon dërgesën ose pjesën e fundit; në raste të kontratave për dërgesë të rregullt të mallrave gjatë një afati të caktuar kohorë, nga dita kur konsumatori ose person i tretë, përveç transportuesit, përcaktuar nga konsumatori, fizikisht e pranon mallin e parë edhe për kontrata për furnizim të ujit, gazit dhe energjisë elektrike, kur nuk ofrohen në shitje në sasi të kufizuar ose cilësi të caktuar, ngrohje qendrore ose përmbajtje digjitale e cila nuk transferohet me mbajtës material i vazhdueshëm, nga dita e lidhjes së kontratës.

Nëse dita e fundit e afatit është ditë që nuk punohet, afati shtyhet deri më ditën e parë pune.

Nëse nuk është përcaktuar, edhe ditët të cilat nuk punohet llogariten brenda afatit.

A duhet konsumatori të ketë arsye serioze dhe të argumentuar që të tërhiqet nga kontrata? Jo! Konsumatori në afat prej 14 ditë mund të tërhiqet nga kontrata e lidhur jashtë hapësirave afariste pa arsye serioze dhe pa i argumentuar arsyet.

A duhet konsumatori ti mbuloj shpenzimet për tërheqjen e kontratës? Jo! Shpenzimet gati çdo herë i mbulon tregtari.

Si duhet konsumatori ta informoj tregtarin? Tërheqja realizohet me anë të Formularit. Tërheqjen e kontratës së lidhur nga larg ose kontratës së lidhur jashtë hapësirave afariste të tregtarit, konsumatori e realizon me plotësimin e Formularit. Forma dhe përmbajtja e Formularit për tërheqje, përcaktohen nga Ministri i Ekonomisë.

### **Cilat janë të drejtat e konsumatorit në rast kur nuk i përcillen informacionet për tërheqjen e kontratës ose informacione të tjera të cilat tregtari është obliguar ti përcjellë në rast kur kontrata është lidhur jashtë hapësirës afariste?**

Nëse nuk i pranoni të gjitha informacionet për të cilat tregtari ka obligim ti ndaj kur lidhni kontratë jashtë hapësirave afariste si dhe informacione për të drejtën për tërheqje, afati për tërheqje skadon pas 12 muajve nga skadimi i afatit për tërheqje. Në rast kur për afat prej 12 muaj sigurohen informacionet të cilat tregtari ka obligim ti ndaj, afati për tërheqje është 14 ditë nga pranimi i këtyre informacioneve.

### **Si mund ta realizoni të drejtën për tërheqje?**

E drejta për tërheqje si konsumator mund ta realizoni, nëse në afatin e caktuar për tërheqje e plotësoni Formularin ose jepni deklaratë të qartë për tërheqjen e kontratës. Kjo mund të realizohet në formë elektronike dhe të dërgohet në ueb faqen e tregtarit. Tregtari duhet ta konfirmoj pranimin e Formularit ose të deklaratës për tërheqje, të cilën e keni dërguar ju si konsumator. Dëshminë se ju ka informuar ose konfirmim për pranim duhet të sigurohet nga tregtari.

### **Cili është efekti nga tërheqja?**

Përmbushja e të drejtës për tërheqje do të thotë se shuhen të drejtat dhe obligimet të palëve të kontraktuara.

### **Cilat janë obligimet e tregtarit në rast kur konsumatori tërhiqet nga kontrata e lidhur jashtë hapësirave afariste? Dhe në cilin afat duhet ti plotësoj?**

Tregtari i rimbursin të gjitha pagesat e pranuar nga konsumatori, përfshirë edhe eventualisht shpenzimet për dorëzim, pa vonesë, në afat prej 14 ditë nga dita kur është i informuar për vendimin e konsumatorit që të tërhiqet nga kontrata.

Kur tregtari do ta realizoj kthimin e mjeteve të cilat i ka pranuar konsumatori? Si do ti kthej tregtari mjetet që i ka pranuar nga konsumatori? Tregtari do ta realizoj kthimin e parave, duke e shfrytëzuar mjetin e njëjtë të pagesës të cilin e ka shfrytëzuar konsumatori për transaksionin fillestar, përveç nëse konsumatori qartë pajtohet për mënyrë tjetër dhe në rast që mos të pësoj humbje si rezultat të kthimit të parave. Tregtari nuk është i obliguar që të mbuloj kostot plotësuese, kur konsumatori në mënyrë të qartë ka deklaruar për një mënyrë të dërgesës përveç të dërgesës më të lirë standarde nga ana e tregtarit. Përveç nëse tregtari ka ofruar që vet ta tërheq mallin, në lidhje me kontratat për shitje, tregtari mund të përmbahet nga kthimi i parave deri sa nuk e pranon mallin ose deri sa konsumatori nuk dërgon dëshmi se e ka kthyer mallin.

### **Si kthehen dhe mallrat dhe çili është afati për kthimin mallrave në rast të tërheqjes së konsumatorit nga kontrata e lidhur jashtë hapësirave afariste?**

Përveç nëse tregtari nuk ka ofruar vet ta tërheq mallin, konsumatori e kthen mallin ose ja dorëzon tregtarit ose personit të tretë i autorizuar për të pranuar mallin, pa shtyrje të panevojshme, ndërsa në çdo rast në afat prej 14 ditë nga dita kur e ka lajmëruar tregtarin për vendimin e tij për tërheqjen e kontratës. Afati përfundimtarë është i plotësuar, nëse konsumatori e kthen mallin para skadimit të afatit prej 14 ditëve. Konsumatori e mbulon shpenzimin për kthimin e mallit, përveç nëse tregtari nuk është pajtuar që ai vet ta mbulon këtë shpenzim ose nuk e ka informuar konsumatorin se ky shpenzim duhet të mbulohet nga konsumatori. Për kontratat të lidhura jashtë hapësirave afariste kur mallrat dërgohen deri në shtëpinë e

konsumatorit në momentin e lidhjes së kontratës, tregtari e kthen mallin dhe shpenzimin e mbulon vet, nëse malli për shkak të natyrës, nuk mund të kthehet me anë të postës. Konsumatori ka përgjegjësi vetëm për uljen e vlerës së mallit që është shkaktuar si rezultat i mirëmbajtjes së mallit ndryshe nga natyra, karakteristikat dhe funksionimit të mallit. Konsumatori në asnjë rast nuk ka përgjegjësi për uljen e vlerës së mallit nëse tregtari nuk e ka informuar konsumatorin për të drejtën e tij për tërheqje në pajtim me ligjin.

### **A keni obligim si konsumator të paguani për një pjesë të shërbimeve të realizuara në ofrtë vendosni të tërhiqeni nga kontrata?**

Kur konsumatori e realizon të drejtën e cila i lejon tërheqje me dërgim të kërkesës, konsumatori i paguan tregtarit vlerë proporcionale për atë që është zbatuar deri në momentin kur konsumatori e informon tregtarin për realizimin e të drejtës për tërheqje, në raport të të gjitha huat të parapara me kontratën. Vlerën proporcionale të cilën konsumatori duhet t'i paguan tregtarit llogaritet sipas vlerës së plotë të përcaktuar me kontratën. Nëse vlera e plotë është tepër e madhe, vlera proporcionale llogaritet sipas vlerës së tregut. Konsumatori nuk ka përgjegjësi për kostot për: kryerjen e shërbimeve ose furnizim me ujë, gaz ose energji elektrike, kur nuk ofrohen në sasi të kufizuara ose me cilësi të caktuar, ose për ngrohje qendrore në tërësi ose pjesërisht, gjatë afatit për tërheqje, kur: tregtari nuk siguron informacione në pajtim me ligjin ose konsumatori nuk ka kërkuar në mënyrë të qartë që realizimi të fillojë gjatë afatit për tërheqje ose sigurimi në tërësi ose pjesërisht të përmbajtjeve digjitale që nuk ofrohen në mbajtës të vazhdueshëm material kur: konsumatori nuk ka dhënë pajtim për fillimin e realizimit para skadimit të afatit prej 14 ditë – konsumatori nuk pranon se e ka humbur të drejtën për tërheqje kur e ka shprehur pajtimin e tij.

### **Vallë të gjithë kontratat plotësuese që ka lidh konsumatori ndërpriten me tërheqjen e konsumatorit nga kontrata e lidhur jashtë hapësirave afariste?**

Në lidhje me kontratat për kredi për konsumatorët, nëse konsumatori e realizon të drejtën e tij për tërheqje të një kontrate të lidhur nga larg ose kontratë e lidhur jashtë hapësirave afariste, të gjithë kontratat plotësuese automatikisht ndërpriten, pa shpenzime të cilat duhet ti mbulojë konsumatori.

### **A ekzistojnë përjashtime dhe çilat janë ato në lidhje me të drejtën për tërheqje? Nga çilat kontrata konsumatori nuk ka të drejtë të tërhiqet?**

Konsumatori nuk mund të tërhiqet nga: kontratat për shërbime pas realizimit të plotë të shërbimit nëse realizimi ka filluar me pëlqim të plotë të konsumatorit dhe me pranimin e faktit se do ta humbin të drejtën për tërheqje pas realizimit të plotë të kontratës nga ana e tregtarit; furnizim i mallrave ose i shërbimeve çmimi i të cilëve varet nga variacioni i tregut financiar të cilin tregtari nuk është në gjendje ta kontrollojë dhe që mund të paraqitet gjatë afatit për tërheqje; furnizimi i mallrave të përpunuara sipas specifikave të ndryshme ose të adaptuara sipas nevojave të konsumatorit; furnizim të materialeve që mund të prishen lehtë ose me afat të shkurtër për përdorim; furnizim të mallrave origjinale të mbyllura të cilat nuk mund të kthehen për shkak të arsyeve higjienike ose për arsye të mbrojtjes së shëndetit dhe janë të hapura pas dërgesës së tyre; furnizim i mallrave të cilat pas dorëzimit, sipas natyrës janë të përziera në mënyrë të pandashme me mallra të tjerë; dhe furnizim të pijeve alkoolike, çmimi i të cilëve është përcaktuar në momentin e lidhjes së kontratës për shitje, dorëzimi i të cilëve mund të realizohet pas 30 ditëve dhe çmimi i të cilëve varet nga variacioni i tregut i cili nuk mund të kontrollohet nga ana e tregtarit; kontratat në të cilat konsumatori në mënyrë të qartë ka kërkuar vizitë nga tregtari lidhur me realizimin e riparimeve urgjente ose të mirëmbajtjeve. Në rast të një vizite të tillë, tregtari siguron shërbime për kërkesat e veçanta të konsumatorit ose mallra përveç pjesëve të këmbimit të domosdoshme për mirëmbajtje ose riparim, duhet të zbatohet e drejta për tërheqjen e këtyre shërbimeve dhe mallrave plotësuese; furnizim të regjistrimeve origjinale të mbyllura audio

dhe video ose softuerëve për kompjuter të cilat janë hapur pas pranimit; furnizim i gazetave, revistave mujore ose revista të tjera me përjashtim të kontratave për parapagesë për furnizim të botimeve të tilla; kontrata të lidhura në ankande publike; sigurim i akomodimit për qëllime të cilat nuk kanë të bëjnë me banim, transport të mallrave, shërbime për makina me qira, shërbime hotelierike ose shërbime për aktivitete gjatë kohës së lirë kur kontrata parasheh datë të caktuar ose afat për realizim dhe dorëzim të përmbajtjes digjitale e cila nuk ofrohet me anë të mbajtësit të përhershëm material, nëse realizimi ka filluar me pëlqim të qartë të konsumatorit dhe me pranimin e tij të faktit se e humb të drejtën për tërheqje.

Konsumatorë keni kujdes! Çdo herë kur mendoni se ambienti, aftësitë për prezantim ose agresiviteti i prezantuesit dhe metodat e tij për marketing janë arsyeja për tregti me mallra dhe shërbime të tregtarit në bazë të ofertës ose kontratave të lidhura jashtë hapësirave afariste të tregtarit kujtoheni në të drejtën tuaj, me kokë të freskët të mendoni për afatin prej 14 ditor dhe të tërhiqeni nga kontrata pa arsyetim dhe pa pasoja.

### Formulari për tërheqjen e kontratës të lidhur jashtëhapësirave afariste të tregtarit

Ministria e Ekonomisë e përcakton formën dhe përmbajtjen e Formularit për tërheqje të kontratës së lidhur jashtë hapësirave afariste të tregtarit me rregullore të veçantë. Formulari për tërheqjen e kontratës nga larg ose kontratës së lidhur jashtë hapësirave afariste të tregtarit dërgohet në formë të shkruar dhe në formë elektronike. Formulari në formë të shkruar është në format A-4 me letër në ngjyrë të bardhë, ndërsa formulari elektronik është në Word dokument.

### Si duket Formulari për tërheqjen nga kontrata e lidhur jashtëhapësirave afariste të tregtarit

Tërheqja e kontratës nga larg ose kontratës së lidhur jashtë hapësirave afariste të tregtarit nga konsumatori (të plotësohet ky Formular dhe të dërgohet nëse dëshironi të tërhiqeni nga kontrata)

- Emri dhe adresa e tregtarit, numri i telefonit, adresa e postës elektronike ose numri i telefaksit (këto të dhëna i plotëson tregtari): \_\_\_\_\_;
- Me këtë unë/ne\* (njoftoj/më për tërheqjen time/tonë (\*) nga kontrata për shitje të këtyre mallrave/shërbimeve: \_\_\_\_\_;
- Porositur më datën \_\_\_\_\_ (\*) / pranuar më datën \_\_\_\_\_ (\*);
- Emri dhe mbiemri, gjegjësisht emri i konsumatorit /-ve: \_\_\_\_\_;
- Adresa e konsumatorit /-ve: \_\_\_\_\_;
- Nënshkrim i konsumatorit/-ve (vetëm nëse ky formular plotësohet me shkrim në letër)

\_\_\_\_\_

-Data \_\_\_\_\_

\* fshi sipas nevojës.



Организација на потрошувачите  
на Република Македонија

Водњанска, 66, П. Факс 150, Скопје  
Тел. 02 3179 592

e-mail: [sovetuvanja@opm.org.mk](mailto:sovetuvanja@opm.org.mk)  
[www.opm.org.mk](http://www.opm.org.mk)